



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 130

Tiranë – E premte, 24 korrik 2015

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike nr. 3477, datë 22.7.2015	Për metodologjinë e klasifikimit, kodifikimit dhe formularët e aplikimit të shërbimeve që ofrohen nga administrata shtetërore..... 6707
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 23, datë 24.6.2015	Për licencimin e “Ujësjetllës-Kanalizime Shkodër” sh.a..... 6709
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 24, datë 24.6.2015	Për licencimin e “Ujësjetllës Shkodër Fshat” sh.a..... 6709
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 25, datë 8.7.2015	Për disa shtesa dhe ndryshime në kontratën model të shërbimeve ujësjetllës-kanalizime..... 6710
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 26, datë 8.7.2015	Për miratimin e udhëzuesit për organizimin e seancës dëgjimore me publikun në procesin e miratimit të tarifave..... 6711





## UDHËZIM

Nr. 3477, datë 22.7.2015

**PËR METODOLOGJINË E  
KLASIFIKIMIT, KODIFIKIMIT DHE  
FORMULARËT E APLIKIMIT TË  
SHËRBIMEVE QË OFROHEN NGA  
ADMINISTRATA SHTETËRORE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, nenit 24 të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 943, datë 9.10.2013, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike”, pika 3, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 693, datë 22.10.2014, “Për krijimin e Qendrës së Ofrimit të Shërbimeve të Integruara”, pika 3, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 444, datë 27.5.2015, pika 3, urdhrin të Kryeministrit nr. 236, datë 24.9.2014 “Për ngritjen e grupeve të posaçme të punës për zhvillimin e Qendrës së Shërbimeve Publike në kuadër të prioritetit qeverisës për reformën në administratën publike për mirëqeverisje inovative”,

## UDHËZOJ:

## I. PARIMET E PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është të përcaktojë metodologjinë që duhet të ndiqet nga institucionet e administratës shtetërore në klasifikimin, kodifikimin dhe formularët e aplikimit të shërbimeve publike që ofrohen prej tyre në favor të personave fizikë dhe juridikë, si dhe përcaktimin e institucioneve përgjegjëse.

## II. TË DHËNAT E KLASIFIKIMIT

1. Klasifikimi i shërbimeve publike në Shqipëri do të bëhet me tri nivele:

1.1 “Funksioni” shkalla e parë e klasifikimit, që pasqyron ndarjen tematike sipas ngjarjeve jetësore dhe përfshin grupe shërbimesh.

1.2 “Grupi i shërbimeve” shkalla e dytë e klasifikimit, që pasqyron një nënndarje të funksionit sipas nëntematikave specifike. Shërbimet që i përkasin një grupi janë të ngjashme midis tyre dhe formojnë një grup, i cili është i dallueshëm nga të tjerët brenda funksionit për shkak të llojit apo qëllimit që ka.

1.3 “Shërbimi”, si shkalla e tretë dhe njësia më e vogël bashkuese e klasifikimit, që pasqyron shërbimin publik në vetvete. Ai tregon shërbimin që ofrohet brenda grupit të shërbimit dhe që është i dallueshëm nga shërbimet e tjera nga lloji apo qëllimi.

2. Klasifikimi i shërbimeve publike është një hap i nevojshëm për kodifikimin e tyre.

## III. TË DHËNAT E KODIFIKIMIT

1. Metodologjia e kodifikimit pasqyron klasifikimin e shërbimeve publike, duke i vënë në korrespondencë një kod shifror funksionit, grupit të shërbimeve dhe shërbimit, të paraprirë nga prefiksi AL. Kodi i shërbimit është unik për çdo shërbim dhe ka formatin AL 00 00 00.

Kodi prefiks	Funksion	Grupi i shërbimeve	Kodi i shërbimit	Përshkrimi i shërbimit
AL	00	00	00	Shërbimi AAA

2. Kodi i prefiksit përbëhet nga kombinimi i shkronjave “AL”. Këto dy karaktere qëndrojnë gjithmonë në fillim të kodit dhe pasohen nga elementet e tjerë të kodit. Qëllimi i tyre është identifikimi i shtetit.

3. Kodi i funksionit përbëhet nga një numër dyshifror, natyror, i cili pason kodin e prefiksit. Ky kod fillon me numrin “01” dhe ka rend progresiv.

4. Kodi i grupit të shërbimeve përbëhet nga një numër dyshifror, natyror, i cili pason kodin e funksionit. Kodi i grupit të shërbimit fillon me numrin “10” dhe rritet progresivisht me 10 numra për çdo grup (si p.sh. grupi 10, grupi 20, ..., grupi 90). Vetëm nëse një funksion përfshin më shumë se nëntë grupe shërbimesh, kodet e mëtejshme të grupeve të shërbimit fillojnë me numrin “05” dhe rriten progresivisht me 10 numra (si p.sh. grupi 05, grupi 15, ..., grupi 95).

5. Kodi i shërbimit përbëhet nga një numër dyshifror, natyror, dhe pason kodin e grupit të shërbimit. Ky kod fillon me numrin “01”, ka rend progresiv dhe përfundon me numrin “99”.

6. Secili grup shërbimesh nuk mund të përmbajë më shumë se 99 shërbime specifike. Në rast të përfundimit të numrave brenda një grupi, për shërbimet e reja, krijohet një grup shërbimi i ri, në përputhje me specifikat e shërbimeve.



#### IV. FORMULARËT E APLIKIMIT

1. Formulari i aplikimit është instrumenti nëpërmjet të cilit institucioni mbledh informacionin e nevojshëm mbi aplikantin për të filluar lëvrimin e shërbimit. Formularët e aplikimit duhet të jenë të standardizuara, të unifikuara si në përmbajtje, ashtu edhe në formë. Këta formularë do të jenë gjithashtu të kodifikuar, në mënyrë që shërbimi përkatës të jetë menjëherë i identifikueshëm.

2. Formularët e aplikimit standardizohen dhe hartohen nga ADISA, e cila ua shpërndan institucioneve të administratës shtetërore.

3. Kodi i formularit të aplikimit të shërbimit është unik dhe formohet si vazhdimësi e kodit përkatës të shërbimit dhe ka formatin AL 00 00 00-0vv.

4. Kodi i formularit të aplikimit pason kodin e shërbimit dhe ndahet prej tij me shenjën “-”. Ky kod ka formatin 0vv. Shifra e parë e kodit fillon me numrin “1” dhe ka rend progresiv. Dy shifrat e tjera tregojnë vitin në të cilin është krijuar dhe/ose ndryshuar formulari dhe pason kodin e formularit.

#### V. PËRGJEGJËSIA E STANDARDIZIMIT

1. Institucioni përgjegjës për hartimin e kodeve dhe të formularëve për çdo shërbim dhe klasifikimin e tyre është Qendra e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA).

2. ADISA harton mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në këtë udhëzim kodifikimin dhe formularët për çdo shërbim dhe ua komunikon atë të gjitha institucioneve shtetërore, që ofrojnë shërbimin përkatës.

3. Institucionet e administratës shtetërore përdorin këto kode në të gjitha shërbimet dhe formularët e aplikimit dhe/apo format e tjera me anë të të cilave ato ofrojnë shërbimin specifik.

4. Për realizimin e procesit të kodifikimit dhe të hartimit të formularëve, ADISA krijon dhe mirëmban një faqe elektronike, nëpërmjet të cilës për çdo nivel të kodifikimit apo formular mund të merren të dhëna apo komente nga institucionet e administratës shtetërore për shtimin, rishikimin, fshirjen, rregullimin apo korrigjimin e tyre.

5. ADISA, së bashku me institucionet e administratës shtetërore nëpërmjet ASPA-s,

ofron trajnimin e personelit të administratës që merret me shërbimet për qëllimin e procesit të kodifikimit, të hartimit të formularëve dhe mënyrën e përdorimit të tyre.

#### VI. SHTIMI, RISHIKIMI DHE FSHIRJA E KODEVE DHE FORMULARËVE

1. Institucionet që kërkojnë të shtojnë një shërbim të ri, të ndryshojnë klasifikimin, kodin e shërbimit dhe/apo formatin e formularëve, duhet të paraqesin kërkesë nëpërmjet faqes elektronike të përcaktuar në pikën 4 të kreut V ose me shkresë zyrtare.

2. Kërkesa duhet që të përmbajë:

- Një përshkrim të shërbimit të ri të ofruar, si edhe sugjerimin për emërtimin e këtij shërbimi;
- Bazën ligjore për shërbimin e ri (ligji, akti nënligjor apo kërkesa të tjera);
- Arsyet për këtë shërbim të ri;
- Arsyetimi që nuk ekzistojnë dallime midis këtij shërbimi dhe funksionit/grupit të shërbimit ku ai do të bëjë pjesë.

3. ADISA shqyrton kërkesën, brenda 10 ditëve dhe shprehet lidhur me plotësinë e saj. Në rast mangësish, i kërkon institucionit që të bëjë plotësimet përkatëse, duke përcaktuar dhe afatin për dhënien e përgjigjes. Në rast se kërkesa është e plotë, ADISA ia përcjell praktikën ministrisë përgjegjëse për krijimin e shërbimit, e cila vepron sipas procedurave ligjore.

4. Në rastin e rishikimit të një shërbimi apo të mbylljes së tij, institucioni që e ofron këtë shërbim paraqet elektronikisht apo me shkresë zyrtare pranë ADISA-s kërkesën për një veprim të tillë, duke u ndjekur e njëjta procedurë e përshkruar më sipër.

#### VII. KODET DHE FORMULARËT AKTUALE

1. Kodet aktuale që u janë dhënë shërbimeve të ndryshme apo formularëve dhe që përdoren nga institucionet për shërbimet që ato ofrojnë, mbeten në fuqi dhe kanë përdorim të brendshëm midis institucioneve.

2. Formularët aktualë që përdoren për shërbime të ndryshme të ofruara nga institucionet e administratës shtetërore mbeten në fuqi deri në zëvendësimin e tyre të plotë nga formularët që miratohen dhe shpërndahen nga ADISA, për secilin shërbim.



## VIII. DISPOZITA TRANZITORE

1. ADISA, brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi, bën klasifikimin e shërbimeve, kodifikimin e tyre dhe hartimin e formularëve të rinj sipas metodologjisë së përcaktuar në këtë udhëzim.

2. Brenda një muaji nga realizimi i procesit të kodifikimit dhe klasifikimit të shërbimeve, institucionet e administratës shtetërore fillojnë zbatimin e kodeve të reja për shërbimet e tyre.

3. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I SHTETIT PËR INOVACIONIN  
DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE  
**Milena Harito**

**VENDIM**

**Nr. 23, datë 24.6.2015**

**PËR LICENCIMIN E “UJËSJELLËS  
KANALIZIME SHKODËR” SHA**

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, Komisioni Kombëtar Rregullator

## VENDOSI:

1. Rinovim licence për efekt të përfundimit të afatit dhe shtesë kategorie për operatorin “Ujësjellës-Kanalizime Shkodër” sh.a. me:

- Drejtues ligjor: Leonard Kepi;
- Drejtues teknik: Shpresa Kodra;
- Drejtues teknik: Marsida Nikshiqi.

2. Operatori “Ujësjellës-Kanalizime Shkodër” sh.a. autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategorinë:

- Kategoria A “Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik”;
- Kategoria C “Për largimin e ujërave të ndotura”;
- Kategoria D “Për përpunimin e ujërave të ndotura.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është: Bashkia Shkodër, komuna Rrethinat (pjes.).

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 2-vjeçare deri më datë 23.6.2017.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI  
**Avni Dervishi**

**VENDIM**

**Nr. 24, datë 24.6.2015**

**PËR LICENCIMIN E “UJËSJELLËS  
SHKODËR FSHAT” SHA**

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, Komisioni Kombëtar Rregullator

## VENDOSI:

1. Rinovim licence, për efekt të përfundimit të afatit, operatorit “Ujësjellës Shkodër Fshat” sh.a. me:

- Drejtues ligjor: Flauers Shoshi;
- Drejtues teknik: Ymer Ramovi .

2. Operatori “Ujësjellës Shkodër Fshat” sh.a. autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategorinë:

Kategoria A “Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik”.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është: bashkia Shkodër (pjes.), Koplík, komunat: Bërdicë, Ana e Malit, Rrethinat (pjes.), Hajmel, Velipojë, Gruemirë, Qendër, Shkrel, Shoshë, Vig-Mnel, Kelmend, Shalë, Postribë, Gur i Zi, Shllakë, Kastrat, Dajç.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 1-vjeçare deri më datë 23.6.2016.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI  
**Avni Dervishi**



**VENDIM**  
**Nr. 25, datë 8.7.2015**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME**  
**NË KONTRATËN MODEL TË**  
**SHËRBIMEVE UJËSJELLËS**  
**KANALIZIME**

Në mbështetje të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, në nenin 3, nenin 13/ pika “d”, nenin 14/ pika “e”, “i”, “j” Komisioni Kombëtar Rregullator

**VENDOSI:**

1. Në kontratën model të shërbimeve ujësjellës - kanalizime bëhen këto ndryshime:

a) Në nenin 7, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Furnizimi me ujë llogaritet në bazë të konsumit real dhe vlerësohet nëpërmjet aparateve matëse. Operatori duhet të instalojë ujëmatësin për çdo Konsumator sipas legjislacionit në fuqi për metrologjinë.”.

b) Në nenin 7, pika 6 ndryshohet si më poshtë:

“a) Operatori që ofron shërbimin e furnizimit me ujë, ka përgjegjësinë ligjore të bëjë të mundur kryerjen e verifikimit periodik për matësit e ujit nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ose një person juridik i autorizuar nga kjo e fundit, sipas legjislacionit shqiptar për metrologjinë.

b) Secila nga palët ka të drejtë të kërkojë që Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ose një person juridik i autorizuar të kryejë një testim të jashtëzakonshëm të matësit në përdorim dhe të hartojë një raport testimi, kur dyshohet për një funksionim jokorrekt të matësit. Operatori e njofton konsumatorin me shkrim për përfundimin e procedurave të verifikimit.

c) Kostot që dalin gjatë testimit të jashtëzakonshëm të matësit do të paguhet nga:

I. kërkuesi, në rastin kur matësi ka shenjë e verifikimit të vlefshme dhe nga testimi rezulton në përputhje me kërkesat metrologjike;

II. përdoruesi i matësit, kur nga testimi rezulton jo në përputhje me kërkesat metrologjike.

ç) Nëse vërtetohet se ujëmatësi nuk ka funksionuar si duhet për arsye teknike dhe si

pasojë vlerësimi i sasisë së ujit të konsumuar është bërë mbi bazën e leximeve të pasakta, Operatori është përgjegjës për vlerën e faturës së fundit tatimore. Nëse vërtetohet se ujëmatësi funksionon si duhet, Konsumatori detyrohet për vlerën e faturës së fundit tatimore.”.

c) Në nenin 7, në fund të pikës 8, shtohet togefjalëshi:

“12 muajve të fundit nga momenti i mungesës së matësit.”

ç) Në nenin 8, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Tarifat e shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura miratohen nga ERRU në bazë të një procesi ligjor dhe transparent. Procedura për vendosjen e tarifave fillon me organizimin e një seance dëgjimore me publikun, propozimin e bërë nga operatori pranë ERRU, dhënien e mendimit nga njësitë e qeverisjes vendore dhe përfundon me miratimin përfundimtar të tarifave nga Komisioni Kombëtar Rregullator i Entit Rregullator të Ujit.”

d) Në nenin 8, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Operatorët duhet të organizojnë një seancë dëgjimore me publikun përpara paraqitjes së propozimit për ndryshim tarife tek ERRU. Qëllimi i kësaj seance është që operatori të kontaktojë me konsumatorët duke i informuar ata rreth zhvillimeve kryesore dhe arsyet për aplikimin për ndryshim tarife.”

dh) Në nenin 8, në pikën 3, fjalia e dytë ndryshon si më poshtë:

“Operatori duhet të njoftojë Konsumatorin me shkrim dhe nëpërmjet medias të paktën 30 ditë përpara aplikimit të tarifave të ndryshuara.”

e) Në nenin 8 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“Tarifat e shërbimeve të miratuara me vendim të Entit Rregullator të Ujit janë të detyrueshme për palët në kontratë.”

ë) Në nenin 9, pika 5 shfuqizohet.

f) Në nenin 10, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Nëse pagesa nuk kryhet brenda afatit, Konsumatori duhet të paguajë kamatëvonesën prej 0.5 për qind të vlerës së konsumit të ujit për çdo ditë vonese, por jo më shumë se 10 për qind e vlerës së faturës.”



g) Në nenin 10, në fund të pikës 3 shtohet togfjalëshi: “nëse aplikohet”.

gj) Në nenin 11, pika 1 dhe 2 ndryshojnë si më poshtë:

“1. Konsumatori që nuk është dakord me vlerën e faturës, ka të drejtë të paraqesë ankesë me shkrim pranë operatorit brenda 30 ditëve nga dita e marrjes në dorëzim të faturës.

2. Konsumatorit, për çdo ankesë që paraqet, duhet t'i jepet një konfirmim zyrtar me shkrim nga Operatori që vërteton datën e dorëzimit dhe numrin përkatës të regjistrimit të ankesës.”

h) Në nenin 13, pika 3, fjalia “Vetëm persona të autorizuar nga Operatori mund të ndërhyjnë tek ujëmatësi në prezencë të Konsumatorit.” shfuqizohet.

i) Në nenin 14, pika 2/ “a”, fjalia me përmbajtje: “Kjo përfshin marrjen e masave të menjëhershme nëse është e nevojshme.” shfuqizohet.

j) Në nenin 15, pika 1 shtohet fjalia me përmbajtje si më poshtë:

“Nëse Operatori nuk e pezullon kontratën në datën e kërkuar nga Konsumatori, ky i fundit nuk është përgjegjës për konsumin e faturuar në faturat pasardhëse të shërbimit.”

k) Në nenin 15, fjalia e dyte e pikës 4, ndryshohet si më poshtë:

“Operatori është përgjegjës për realizimin teknik të rilidhjes së shërbimit brenda 2 ditëve nga data e kërkuar nga Konsumatori.”

l) Në nenin 15, pika 6 shfuqizohet.

ll) Në nenin 16, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Konsumatori duhet që jo më vonë se 15 ditë para datës së zgjidhjes së kontratës t'i paraqesë Operatorit kërkesën me shkrim duke përcaktuar datën e zgjidhjes së kontratës.”

m) Në nenin 16, pika 4, fjalia e parë ndryshon si më poshtë:

“Konsumatori është përgjegjës për të gjithë sasinë e furnizuar nga Operatori deri në datën e zgjidhjes së kontratës.”

n) Në nenin 17, pika 4 dhe 5 shfuqizohen.

o) Në nenin 18, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Kundër Vendimit të Drejtuesit Ligjor të Operatorit, mund të bëhet ankim në gjykatë.”

p) Në nenin 19, pika 3, fjalia “Institucionet apo organet administrative që kanë marrë një

ankesë nga konsumatori duhet të bashkëpunojnë me ERRU për informimin dhe mundësinë e zgjidhjes së këtyre ankesave.” shfuqizohet.

q) Neni 21, fjalia e parë ndryshon si më poshtë:

“Kjo kontratë hartohet, interpretohet dhe zbatohet në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.”

r) Neni 22 ndryshohet si më poshtë:

“Në rast se gjatë zbatimit të kësaj kontrate lindin mosmarrëveshje, palët do të përpiqen t'i zgjidhin këto mosmarrëveshje me mirëkuptim midis tyre dhe në rast të kundërt secila nga palët mund t'i drejtohet gjykatës.”

s) Neni 23 ndryshohet si më poshtë:

“1. Kushtet e përgjithshme të kësaj Kontrate, janë subjekt i ndryshimeve nga ana e ERRU-s, sipas së njëjtës procedurë të miratimit të tyre. Operatori njofton çdo Klient mbi ndryshimet e bëra në Kontratë 30 ditë para hyrjes në fuqi të saj.

2. Kjo Kontratë hyn në fuqi në datën e përcaktuar nga ERRU dhe kushtet e saj bëhen të aplikueshme automatikisht për të gjithë klientët.

3. Në rast të kontestimit të këtyre kushteve nga ana e Klientit, ai mund të heqë dorë nga Kontrata pa asnjë penalitet.”

2. Ngarkohet Sektori Juridik dhe Marrëdhënieve me Publikun për ndjekjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Avni Dervishi

## VENDIM

Nr. 26, datë 8.7.2015

### PËR MIRATIMIN E UDHËZUESIT PËR ORGANIZIMIN E SEANCËS DËGJIMORE ME PUBLIKUN NË PROCESIN E MIRATIMIT TË TARIFAVE

Në zbatim të nenit 14, germa “e” dhe “i”, të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, Komisioni Kombëtar Rregullator



## VENDOSI:

1. Të miratojë “Udhëzuesin për organizimin e seancës dëgjimore me publikun në procesin e miratimit të tarifave”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë e pandarë e tij.

2. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Avni Dervishi

## UDHËZUES

PËR ORGANIZIMIN E SEANCËS  
DËGJIMORE ME PUBLIKUN NË  
PROCESIN E MIRATIMIT TE TARIFAVE

Neni 1  
**Objekti**

Ky udhëzues është miratuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator dhe shërben për të përcaktuar procedurat që duhet të ndiqen nga operatorët e mëdhenj për organizimin e seancës dëgjimore me publikun, si pjesë e procesit të dokumentacionit për aplikim për ndryshim të tarifave të shërbimeve ujësjellës-kanalizime.

Neni 2  
**Fusha e zbatimit**

Ky udhëzues është miratuar nga Komisioni me vendim nr. 26, më datë 8.7.2015, në bazë të ligjit nr. 8102, të ndryshuar, neni 14, germa "e", dhe është i detyrueshëm të zbatohet nga të gjithë operatorët ujësjellës-kanalizime.

Neni 3  
**Përkufizime**

“Enti Rregullator i Ujit (ERRU)” është institucioni i pavarur që rregullon sektorin e furnizimit me ujë, të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura në përputhje me ligjin nr. 8102 (të ndryshuar).

“Komisioni” është Komisioni Kombëtar Rregullator që udhëheq Entin Rregullator të Ujit që funksionon në bazë të ligjit nr. 8102 (të ndryshuar).

“Konsumatorë” janë të gjitha kategoritë e përfituesve familjarë, publikë dhe privatë (të

tanishëm dhe në të ardhmen) të cilët përdorin shërbimet e furnizimit me ujë dhe/ose kanalizimeve.

“Shërbimet UK” është tërësia e shërbimeve të kryera nga operatorët tek konsumatorët përmes sistemeve të furnizimit me ujë, si dhe sistemeve të grumbullimit, largimit dhe/ose trajtimit të ujërave të ndotura.

“Operator” është subjekti i licencuar nga ERRU që ushtron aktivitetet e shërbimit të furnizimit me ujë, grumbullimit, largimit e trajtimit të ujërave të ndotura dhe ofron një ose disa nga këto shërbime sipas kategorive të përcaktuara në licencë.

Neni 4  
**Organizimi i seancës dëgjimore**

Përpara paraqitjes së propozimit për ndryshim tarife tek ERRU, operatorët UK duhet të organizojnë seancë dëgjimore me publikun.

Neni 5  
**Qëllimi i seancës dëgjimore**

1. Operatori zhvillon seancën dëgjimore me publikun me qëllim informimin dhe diskutimin me konsumatorët lidhur me ndryshimin e tarifave, arsyet e këtyre ndryshimeve, planet për të ardhmen, si dhe marrjen e komenteve nga palët e interesuara lidhur me këtë propozim.

2. Seanca duhet të zhvillohet te paktën 30 ditë kalendrike përpara dorëzimit të aplikimit për ndryshim të tarifave pranë ERRU.

Neni 6  
**Fillimi i seancës dëgjimore**

1. Një seancë dëgjimore fillon mbështetur në urdhrin e administratorit të operatorit.

2. Urdhri sipas pikës 1 të këtij neni përcakton:

a) Autoritetin dhe juridiksionin nën të cilin mbahet seanca e dëgjimit;

b) Personin drejtues, si rregull, është personi përgjegjës për çështjet ekonomike;

c) Personat e tjerë të ngarkuar për mbarëvajtjen e seancës dëgjimore;

d) Datën, orën dhe vendin e seancës dëgjimore;

e) Çdo çështje tjetër të përshtatshme.

3. Personi drejtues përgatit informacionin që duhet paraqitur gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.





### Neni 7 Njoftimet

1. Operatori njofton publikun për zhvillimin e seancës dëgjimore nëpërmjet:

- njoftimeve të shpallura në pikat e kujdesit të klientit dhe në të gjitha pikat e tjera të arkëtimit;

- në ambientet e jashtme të njësisë vendore ku ofron shërbime operatori;

- në televizionin lokal dhe në një gazetë të përditshme me qarkullim kombëtar, të paktën një javë përpara mbajtjes së seancës dëgjimore;

- njoftimit zyrtar, të secilit nga palët që ka shprehur interes për procesin, njësinë/njësitë vendore, përfaqësues të shoqatave për mbrojtjen e konsumatorëve, dhe ERRU, jo më vonë se një javë nga data e planifikuar për zhvillimin e seancës.

2. Njoftimi përmban informacion mbi datën, orën, vendin, qëllimin e zhvillimit të seancës dëgjimore.

### Neni 8 Procedurat e zhvillimit të seancave dëgjimore

1. Gjatë seancës dëgjimore duhet të jenë të pranishëm administratori i operatorit, përfaqësues të njësisë vendore ku ofron shërbimin operatori në fjalë, përfaqësues të ERRU, si edhe persona të tjerë sipas gjykimit të operatorit.

2. Personi drejtues në fillim të seancës dëgjimore duhet t'u shpjegojë palëve procedurën dhe rregullat e tjera të zhvillimit të seancës dëgjimore. Ai mund të prezantojë çështjen që do të trajtohet.

3. Seanca dëgjimore regjistrohet në magnetofon ose në pajisje të tjera elektronike audiovizive, gjë që iu bëhet e ditur palëve në fillim të seancës.

### Neni 9 Rregulla të zhvillimit të seancës dëgjimore

1. Gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore personi drejtues do të sigurojë të drejtën e fjalës për secilën nga palët prezent në seancë që e kërkon një gjë të tillë.

2. Çdo person që merr pjesë ka të drejtë të dëgjojë, të mbajë shënime, e të bëjë pyetje sipas radhës së caktuar nga personi drejtues i seancës.

3. Ndalohet ndërprerja e fjalës së folësit dhe përdorimi i celularëve gjatë diskutimeve.

4. Nëse ndonjë nga personat pjesëmarrës konsiderohet se prish qetësinë dhe mbarëvajtjen e seancës dëgjimore, me urdhër të personit drejtues vendoset largimi i tij nga seanca.

5. Në fillim, personi drejtues prezanton aplikimin, objektivat e operatorit dhe nevojën për ndryshimin e tarifave, dhe më pas ftohen palët të shprehin komentet dhe pyetjet e ndryshme lidhur me aplikimin.

6. Palët gjatë seancës dëgjimore mund të paraqesin edhe komente me shkrim të cilat administrohen nga operatori. Këto komente diskutohen gjatë seancës dëgjimore.

7. Në përfundim të dëgjimit të të gjitha palëve dhe dhënies së përgjigjeve, personi drejtues deklaron mbylljen e seancës.

8. Nëse seanca kërkon një kohë më të gjatë nga ajo e planifikuar, personi drejtues në këshillim edhe me palët prezent, mund të vendosë vazhdimin e seancës në një ditë tjetër.

### Neni 10 Transkriptimet

1. Çdo deklaratë e bërë gjatë seancës dëgjimore transkriptohet (zbardhet) në një raport të saktë, pa hequr asgjë, përveç kur personi drejtues urdhëron me shkrim heqjen nga regjistrimet të deklaratave fyese.

2. Pas mbylljes së një regjistrimi, ndryshimet në transkriptim nuk lejohen, përveç rasteve të parashikuara në pikën 3 të këtij neni.

3. Çdo korrigjim në transkriptimin e një seance dëgjimi mund të bëhet, vetëm nëse personi drejtues vendos së korrigjimi përputhet me regjistrimin audioviziv në seancën dëgjimore.

### Neni 11 Dokumentacioni

1. I gjithë dokumentacioni i seancës dëgjimore, si urdhri për organizimin e seancës, informacioni i paraqitur gjatë seancës, regjistrimi audioviziv, procesverbali, komentet me shkrim, etj., administrohen në dosjen e seancës dëgjimore.

2. Dosja ruhet sipas rregullave arkivore dhe është e hapur për inspektim publik.



Neni 12  
**Raportimi**

1. Personi drejtues, brenda 5 ditëve pune nga përfundimi i seancës dëgjimore përgatit, një raport me shkrim lidhur me komentet e marra gjatë seancës, konkluzionet e seancës, rekomandimet e mundshme, etj dhe ia paraqet administratorit të operatorit.

2. Një kopje e këtij raporti i dërgohet ERRU-së bashku me gjithë dokumentacionin për aplikim për ndryshimin e tarifave.



	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2015

Adresa  
Bulevardi “Gjergj Fishta”,  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,  
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 84 lekë